

## Ndihma ekonomike dhe Mbështetja financiare për fëmijën | Çfarë duhet të dini

### Si mbivendosen ndihma ekonomike dhe mbështetja financiare për fëmijën

Aplikantët dhe marrësit e ndihmës ekonomike me një fëmijë minore të përfshirë në buxhetin e tyre të ndihmës ekonomike (dhe me prindin tjetër që banon në një banesë tjetër), duhet të marrin pjesë në një intervistë me Zyrën e Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën në Qytetin e Nju-Jorkut (NYC Office of Child Support Services (OCSS)). Juve do t'ju kërkohet të na jepni informacion rreth prindit tjetër, të referuar si "prindi jokujdestar". Kjo do ta ndihmojë OCSS-në ta paraqesë çështjen në Gjykatën e Çështjeve Familjare për të përcaktuar atësinë/amësinë dhe një urdhër të mbështetjes financiare për fëmijën, nëse nuk ka një të tillë.

Mund të merrni deri në \$200 në muaj mbi shumën e përfitimit tuaj nëse prindi tjetër bën pagesat prej të paktën \$200 (\$100 nëse keni vetëm një fëmijë). Në varësi të detajeve të çështjes suaj, mund të duhen mesatarisht 8 muaj që pagesat të nisin. Paratë shtesë të mbledhura nga prindi tjetër në çështjen për mbështetjen financiare për fëmijën do të përdoren për të shlyer përfitimet e ndihmës ekonomike që keni marrë ju dhe familja juaj.



Përpara se të shkoni te takimi juaj, lexoni "**Njoftimin mbi përgjegjësitë dhe të drejtat për mbështetjen financiare LDSS-4279**" dhe "**Informacionin për të gjithë aplikantët e mundshëm të mbështetjes financiare për fëmijën në lidhje me marrjen e mbështetjes financiare për fëmijën në mënyrë të sigurt W-280a**". Nëse keni shqetësime në lidhje me sigurinë pas leximit të këtyre dokumenteve, kontaktoni punonjësën e FIA-së, i cili do t'ju referojë te një Koordinator i HRA-së për Dhunën në Familje. Së bashku mund të vendosni nëse marrja e mbështetjes financiare për fëmijën është një veprim i sigurt për ju dhe familjen tuaj.

Kopjet dhe përkthimet e këtij dokumenti dhe të të gjithë dokumenteve të referuara mund t'i gjeni në <https://on.nyc.gov/custodialparent> ose përdorni kodin QR më poshtë.



## Pasojet e mospajimit


Nëse nuk bashkëpunoni me programin e mbështetjes financiare për fëmijën, mund t'ju reduktohen përfitimet.

- Ndihma ekonomike për ju mund të reduktohet me të paktën 25%;
- Mund të humbisni shërbimet e Medicaid për veten, jo fëmijët
- Mund të humbisni të drejtën e përzgjedhjes për disa programe të ndihmës për qiramarrje ose mund t'ju reduktohet mbështetja financiare për shpenzimet e qirasë;
- Nuk do të merrni pagesa të mbështetjes financiare për fëmijën deri në \$200 në muaj në shtesë të përfitimit tuaj të ndihmës ekonomike, as përfitime të tjera, pasi të mbyllet çështja e ndihmës ekonomike.

Për të rikuperuar përfitimet tuaja plotësisht, prindërit mund të bashkëpunojnë me shërbimet e mbështetjes financiare për fëmijën në çdo moment, gjatë orareve të punës. Kontaktoni një zyrë OCSS të zonës për të zbuluar se si të rikuperoni përfitimet tuaja plotësisht. Shihni <https://on.nyc.gov/contactocss> për vendndodhjen e zyrës.

## Procesi i mbështetjes financiare për fëmijën

Procesi i mbështetjes financiare për fëmijën nis me intervistën e parë të detyrueshme në OCSS.



### MARRËVESHJET

Dëshironi të reduktoni kohën në gjykatën e çështjeve familjare dhe të dini detajet e urdhrit të mbështetjes financiare për fëmijën përpara datës së gjyqit? Lexoni rreth marrëveshjeve në

<https://on.nyc.gov/custodialparent>.

Kopjet dhe përkthimet e këtij dokumenti dhe të të gjithë dokumenteve të referuara mund t'i gjeni në <https://on.nyc.gov/custodialparent> ose përdorni kodin QR më poshtë.



## Llogaritja e mbështetjes financiare për fëmijën

Gjykata e Çështjeve Familjare vendos shumën që duhet të paguajë prindi tjetër në bazë të të ardhurave të tij/saj dhe numrit të fëmijëve që keni së bashku. Shuma bazohet në udhëzimet e caktuara nga shteti i Nju-Jorkut dhe është e shkruar në një dokument ligjor të quajtur urdhri i gjykatës për mbështetjen financiare për fëmijën. Urdhri i gjykatës i kërkon prindit tjetër të paguajë një shumë të caktuar të parave në një plan kohor të përcaktuar. Shumën e mbështetjes financiare për fëmijën nuk e vendos OCSS-ja. Gjatë seancës gjyqësore, mund të lëshohet një urdhër i përcaktimit të atësisë/amësisë, që emëron prindin tjetër si prindi përgjegjës ligjërisht i fëmijës.

## Shpjegimi i pagesave tranzitore

Nëse ekziston një urdhër gjykate i mbështetjes financiare për fëmijën gjatë kohës që fëmija merr ndihmë ekonomike, pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën i detyrohen Departamentit të Shërbimeve Sociale (Department of Social Services (DSS)) për të shlyer përfitimet e ndihmës ekonomike që ka marrë familja juaj. Megjithatë, nëse mblidhet mbështetja financiare për fëmijën, ju do të merrni një bonus ose “pagesë tranzitore” mbi pagesën e ndihmës ekonomike, e cila do të shtohet në kartën tuaj EBT. Pagesat tranzitore nuk llogariten si të ardhura kundrejt pjesës SNAP të çështjes.

- Një fëmijë: juve do t’ju jepen \$100 e para të pagesave të mbështetjes financiare për fëmijën të mbledhura çdo muaj.
- Dy ose më shumë fëmijë: ju do të merrni \$200 e para të pagesave të mbështetjes financiare për fëmijën të mbledhura çdo muaj.



Nëse prindi tjetër ju jep para ndërkohë që merrni ndihmë ekonomike, ju duhet t’ua jepni ato HRA-së. Mbajtja e këtyre pagesave të mbështetjes financiare për fëmijën konsiderohet mashtrim mirëqenieje.

## Pas mbylljes së çështjes së ndihmës ekonomike

Kur të mos merrni më ndihmë ekonomike, të gjitha pagesat aktuale të mbështetjes financiare për fëmijën do t’ju dërgohen juve. Ju do të vazhdoni të merrni shërbimet në zbatim të mbështetjes financiare për fëmijën pa shpenzime nga ana juaj.

Kopjet dhe përkthimet e këtij dokumenti dhe të të gjithë dokumenteve të referuara mund t’i gjeni në <https://on.nyc.gov/custodialparent> ose përdorni kodin QR më poshtë.

